PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

"Impiant për prodhimin e betonit"

INVESTITORI: Albit Construction

HARTOI : GR Albania

Gusht 2018

Titulli i Projektit:	**"Impiant prodhim betoni"**
Investitori:	**"Albit Construction" sh.p.k**
Përgatitur nga:	**GR ALBANIA sh.p.k :**
GR ALBANIA	**Gusht, 2018**

PËRMBAJTJA

1 Hyrje 4
2 Përshkrimi i Projektit 4
2.1 Përshkrim I mjedisit në zonën ku do zhvillohet aktiviteti 7
2.1.1 Foto te ambienteve te impiantit te prodhimit te betonit 8
3 Identifikimi I ndikimeve në mjedis 9
3.1 Metodologjia per vleresimin e ndikimeve 9
3.2 Impaktet në mjedis 11
3.2.1 Ndikimi në biodiversitet 11
3.2.2 Ndikimi në tokë 11
3.2.3 Ndikimi në ajër 11
3.2.4 Ujëra të ndotura 11
3.2.5 Zhurma dhe vibrime 12
3.2.6 Gjenerimi I mbetjeve 12
4 Masat zbutëse të ndikimeve negative në mjedis 12

Lista e Figurave

Figura 1-1: Vendndodhja e projektit 4
Figura 2-1: Pamje satelitore e vendndodhjes se projektit 5
Figura 0-3 : Paraqitja ciklit të prodhimit të betonit 7

Lista e tabelave

Tabela 3-1: Klasifikimi i ndikimit 10

1 HYRJE

Kompania "ALBIT CONSTRUCTION" sh.p.k e regjistruar në QKB me nipt K77531301U synon të zhvillojë aktivitetin e prodhimit e betonit. Aktiviteti ndodhet Objekti ndodhet në anën e majtë të rrugës nacionale E762 Tiranë –Milot, Njësia Administrative Fushë-Kuqe, Laç, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë. Ky raport vlerësimi hartohet me kërkesë të subjektit ALBIT CONSTRUCTION sh.p.k me seli kryesore në Laç, rruga e Patokut, me përfaqësues ligjor Z. Roland Kocli.

Bazuar në ligjin për Vlerësimin e ndikimit në mjedis nr.10440, datë 07.07.2011, I ndryshuar, ky aktivitet nuk përfshihet te asnjë nga shtojcat e këtij ligji në lidhje me projektet që duhen ti nënshtrohen procedurës paraprake ose thelluar të VNM-së. Pas marrjes së mendimit të AKM-së për vazhdimin e procedurës, vendim datë 30.08.2018, me numër Prot. 2485/1ky aktivitet do të pajiset vetëm me Leje Mjedisore sipas shtojcës 1, Ligj Nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit".

Sipas ligjit Nr. 60/2014: Për një ndryshim në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, klasifikohet Tipi B sipas shtojcës 1 pika 3.1 e).

Figura 1-1: Vendndodhja e projektit

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objekti ka si qëllim përgatitjen e betonit të markave të ndryshme, si:

- M 200
- M 250
- M 300

Për zhvillimin e verpimtarisë subjekti ka instaluar të gjitha facelitet e nevojëshme si dhe siguron hapsira të mjaftueshme për magazinimin e lëndëve të para, siç janë:

1. Granil
2. Rëre
3. Çimento

Materialet e siperpermendura meren nga subjekte të kontraktuara.

Kapaciteti :

Kapaciteti I prodhimit të betonit nga ky impaint është i ndryshëm nga dita në ditë dhe nga muaj në muaj, pasi prodhimi varet nga kërkesat e klientëve.

Kapaciteti i instaluara i impaintit:

- Kapaciteti Teorik (pra kapaciteti sipas manualit) është **120 m^3/orë,**
- Kapaciteti Praktik (që do të thotë kapacioteti i arritur) është **100 m^3/orë,**

Sipërfaqja :

Territori në të cilin zhvillohet ky aktivet është pronësi e Shoqërisë "ALBIT CONSTRUCTION" Shpk. Territori ka Sipërfaqe 7300 m^2. Zona Kadastrale nr.2365, me pasuri nr.336/9.

Figura 2-1: Pamje satelitore e vendndodhjes se projektit

Proceset kryesore në impiantin e prodhimit:

Proçesi i punës qe ndiqen janë si më poshtë:

- Magazinimi i lëndëve të para.

Agregatet depozitohen dhe magazinohen në venddepozitime të ndara ne territorin e aktivitetit, ku sheshi është i mirë sisitemuar, i betonuar si dhe i rrethuar pranë zonës së instalimeve të impiantit të betonit.

- Peshimi i materialeve (agregateve).

Për të prodhuar beton të gatshëm, agregatet transferohen nga vend-magazinimi dhe peshohen në sasi të saktë, të përcaktuara si nga specialist dhe tekniket përkatës.

- Perdorimi I sasise se ujit dhe materialeve shtesë.

Uji dhe aditivët hidhen sipas markës së betonit. Uji është elemeti që realizon miksimin e tyre me njëra tjetrën duke reaguar kimikisht me çimenton dhe shtesat e tjera. Shtesat shtohen sipas markës përkatëse të betonit.

- Çimento.

Çimentoja transferohet për në impiantin e betonit me kamionët me çisternë të posacëm, ku ajo ruhet në sillosa. Çimento është materiali më i rëndësishëm për proçesin e prodhimit të betonit. Hidratimi i çimentos, reaksioni kimik midis çimentos dhe ujit, ndikojne ne ngurtesimin e betonit. Raporti ujë/çimento përcaktojnë tipin e betonit si një element tepër i rëndësishëm, si vetitë e saj kryesore fortësia dhe qëndrueshmëria. Në varësi të markës së kërkuar, sasia e saktë e çimentos peshohet dhe shtohet në njësinë e përziersit për përzierjen së bashku me agregatet e tjerë, ujin dhe aditivët.

- Përzierja e lëndeve të para.

Në proçesin e prodhit të betonit, koha e përzierjes së lëndëve të para është shumë specifike,në mënyrë që të marrë një masë homogjene me agregatët, çimenton, ujin dhe aditivët perkates. Te gjitha materialit miksohen sipas formules se caktuar per te prodhuar marken specifike.

- Transporti drejt klienteve/konsumatorit (firmat e ndërtimit).

Betoni i gatshëm sipas kërkesës së konsumatorit transferohet nga impianti I prodhimitte betonit, për në objekt me anë të betonierave të cilët e përziejnë gjatë gjithë rrugës për në sheshin e ndërtimit në mënyrë që të jetë sa me homogjene dhe të mos ngurtësohet.

Betoni është një masë e përbërë nga material inerte të thata (Rërë, granil) dhe nga cimento e aditivë të ndryshëm që ndihmojnë procesin e tharjes e të ngrirjes së betonit. Kjo përbërje është një material natyror dhe i ricikluesheм dhe është i përdorshëm në fushën e ndërtimit.

Betoni prodhohet në këtë mënyrë: Në sillosat e furnizimit me lëndë të parë me inerte, hidhet rërë dhe granil i përmasave të ndryshme, sipas cilësisë së kërkuar të betonit. Nga këtu, inertet kalojnë në mikser nëpërmjet transportiereve të cilët punojnë me energji elektrike. Në mikser, pasi kryhet përzierja e tyre, shtohet edhe cimento e lëngët dhe additivë të ndryshëm për të krijuar cilësinë dhe vetitë e kërkuara të betonit. Kryhet miksimi ose përzierja e elementeve përbërës dhe pastaj kalon menjëherë në sillosen e ngarkimit të kamioneve që do të kryejnë transportimin e betonit për në vendin e përdorimit, në kantierin e ndërtimit.

Figura 2-2 : Paraqitja ciklit të prodhimit të betonit

2.1 Përshkrim I mjedisit në zonën ku do zhvillohet aktiviteti

Zona ku do të zhvillohet aktiviteti ndodhet në Laç, Bashkia Kurbin, Qarku I Lezhës. Bimësia ne rajon është e shpërndarë sipas kushteve klimatike, duke formuar zona bimësie si zona e shkurreve mesdhetare (zhvillohen shkurret, kryesisht shqopa e mareja), e dushqeve (lisi, gështenja), e ahishteve (ahu) dhe e halorëve (pisha). Duke u nisur sipas vetive të përdorimit në zonë rriten edhe bimët mjeksore e aromatike që përmbajnë lëndë aktive dhe esenca. Bimët mjekësore që rriten në këtë zonë janë: sherebela, trumza, kamomili, lulebliri, çaj mali, luleshtrydha, lulëkuqja, mullaga. Në kete zone rriten edhe bimët spontane foragjere me vlera ushqimore për bagëtinë. Zona e projektit ndodhet ne një territor me reliev te sheshte, e perbere nga toka me mozaikë bujqësor.

Në një distance prej 1.7 km nga projekti ndodhet Kompleksi Ligatinor I Patokut. Shumellojshmeria e bimesise eshte nje nga karakteristikat me spikatese te ketij kompleksi.

Nga bimet detare, ne pjesen perendimore, me te zakonshmet jane livadhet nenujore te Fucus virsoides dhe Posidonia oceanica. Bimësia ujore e lagunës karakterizohen nga sasi e madhe e mikroalgave, sepse ka rritje të shpeshtë të trofise si rrjedhojë e rritjes së azotit dhe fosforit. Një nga treguesit e kesaj gjendjeje është edhe sasia e lartë e diatomeve. Makroalgat e lagunës i përkasin algave të gjelbra (Chlorophyta) dhe algave të murrme (Pheophyta). Livadhet e fanerogameve mbulojne rreth 40% të fundit të lagunës. Ato përbëhen nga Zostera noltii, por në ujra të cekët dhe të qetë gjendet gjithashtu Ruppia spiralis. Kjo fitocenozë ka një rol shumë te rendesishem në lagunë. Bimësia higro dhe hidrofile mbulon një zonë të konsiderueshme të pjesëve periferike të lagunës. Ato dominohen nga 3 shoqërime kryesore të kallamishtes (Phragmites), shavarit (Thypha) dhe shqirres (Scirpus). Bimesia halofile eshte me e pranishme në pjesën veriore dhe jugore të lagunës. Kjo bimësi i perket disa shoqërimeve, nga të cilat me të rëndesishme jane ato me Arthrocnemum dhe Juncus. Bimesia e dunave gjendet kryesisht ne pjesen perendimore, me një numer të lartë llojesh. Shkurret ne brigjet e lagunës dominohen nga marina (Tamarix), konopica (Vitex) dhe manaferra (Rubus).

Fauna

Fauna është zhvilluar në vartësi të mjedisit. Kështu dallohen fauna tokësore, fauna e ujrave të ëmbla dhe fauna e egër.Pozita e favorshme gjeografike, klima mesdhetare, relievi që varion nga fushor e deri në reliev të thyer malor, dalja e afërt në det (grykëderdhja e lumit Mat) kanë bërë që fauna të jetë e pasur. Në ujrat e ëmbla rriten peshq si ballëgjëri, krapi, qefulli etj. Shpendë permendim e patën e egër, thëllënza, karabullakët, çapkat etj.Kafshë të egra që rriten në këtë zonë janë dhelpra, lepuri, ujku, ariu dhe derri i egër.

Zona ku zhvillohet aktiviteti nuk vleresohet si zonë me status të veçantë . Projekti ka një distancë të konsiderueshme nga Laguna e Patokut (rreth 1.7 km në vijë ajrore).

2.1.1 Foto të ambienteve të impiantit të prodhimit të betonit

Hyrja ne objekt dhe sheshi kryesor

Magazinimi I rërës

Impianti I betonit

Zona e sitjes

Transporti I betonit

3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

3.1 Metodologjia per vleresimin e ndikimeve

Nje metode vleresimi duhet te percaktoje te gjitha ndikimet te cilat lindin drejt per drejte apo ne menyre te terthorte nga ndertimi apo nga operimi i projektit dhe gjithashtu duhet të për rcaktojë në cilen fazë të projektit lindin dhe cila është kohë zgjatjta e tyre. Përcaktimi i ndikimeve u realizua nga nje hulutim i mire i projektit teknik dhe parashikimi i ndikimeve të mundshme që lindin gjatë fazave të ndryshme të tij në mjedis.

Për vlerësimin e ndikimeve mjedisore të cilat parashikohne operimit të projektit është parë e arsyeshme që karakteristikat mjedisore të klasifikohen në tre kategori:

a) Indikatorët abiotike

b) Indikatorët biotike

g) Indikatorët social/ekonomik

Grupimi i faktoreve mjedisore ndihmon ne nxjerrjen e shpejte te nje konkluzioni per gjendjen e mundeshme te mjedisit, ndihmon ne ekzaminimin e problematikes duke mos humbur kohe

dhe mbi te gjitha jep mundësine e krahasimit me ndikimet e të njëjtës natyrë në VNM. Në tabelën e mëposhtme paraqitet klasifikimi i faktorëve mjedisore të cilët mund të ndryshojnë në lidhje me fazat e projektit. Në vazhdimesi të VNM vlerësohen të gjithë parametrat e poshtëpërmendura

Metoda e vlerësimit së ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Tabela 3-1: Klasifikimi i ndikimit

Vlerësimi	Përshkrimi
Rëndësia	
Pa ndikim	Nuk egzistojnë ndikimet në mjedis.
Ndikim I papërfillshëm	Ndikimi në mjedis nuk do të rezultojë në asnjë ndryshim të dukshëm në vlerën e tij dhe aktiviteti i propozuar do të ketë impakt shumë minimal, thuajse të pakonsiderueshëm në implementimin e tij.
Ndikim I ulët	Projekti ndikon pak në vlerat natyrore duke patur parasysh sasinë dhe cilësinë.
Ndikim mesatar	Vlerat mjedisore do të preken për shkak të shkallës së ndikimit dhe ndjeshmërisë. Ndryshimet janë të përkohshme dhe nuk do të ndikojnë negativisht në qëndrueshmërine e mjedisit. Duhet të shoqërohet njëkohësisht me masa kontrolluese dhe menaxhuese.
Ndikim I lartë	Ndodh kur aktiviteteti ka gjasa të përkeqësojë gjendjen e mjedisit duke cënuar karakteristikat e tij dhe elementet strukturore të vlerave mjedisore. Projekti shkakton ndryshim madhor në vlerat natyrore dhe habitatin e zonës, shpesh duke u shoqëruar me ndikim të pakthyeshëm (efekti negativ do të vazhdojë në mjedis duke sjellë degradim). Rehabilitimi konsiderohet I vështirë në këtë fazë.
Kohëzgjatja e ndikimit	
Afatshkurtër	Parashikohet të zgjase vetëm për kohëzgjatjen e periudhës së ndërtimit.
Afatgjatë	Që do të vazhdojnë për gjithë jetën e Projektit, por pushon kur projekti ndalon operimin.
I përhershëm	Impakte të përhershme që shkaktojnë një ndryshim të përhershëm në receptorin ose burimin e prekur.
Kthyeshmëria (Reversibiliteti)	

I kthyeshëm	Gjasat që një parameter I matur mjedisor do të rikuperohet nga impakti mjedisor përmes teknikave të menaxhimit të mjedisit.
I pakthyeshëm	Dhe pse mund të meren masat rehabilituese, mjedisi nuk mund të kthehet sërish në gjendjen e mëparshme.

Ky vlerësim është mbështetur vetëm në disa nga kriteret e listuara më sipër dhe në vecoritë e mjedisit ku do të zhvillohet projekti. Mbi këtë vlerësim do të orientohen edhe masat që duhet të merren për të zbutur ndikimet, të cilat përbejnë dhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit.

3.2 Impaktet në mjedis

3.2.1 Ndikimi në biodiversitet

Duke patur parasysh faktin që aktiviteti tashmë është egzistues, pra nuk do të ketë fazë ndërtimore dhe si e tillë nuk do te ketë 'shqetësim' apo ndikim në florë dhe faunë. Por, subjekti duhet të marrë masat e duhura (të përshkruara në kapitullin 8, në vijim) në mënyrë që të minimizohet impakti në mjedis.

3.2.2 Ndikimi në tokë

Ndotja mund të vijë si pasojë e avarive teknike të makinerive dhe derdhjeve aksidentale (karburante, vajra) të makinerive në mjedis. Kompania në brendësi të siperfaqes së aktivitetit ka dhe një ambjent shërbimi, oficinë mirëmbajtjen e makinerive që I shërbejnë qëllimit të aktivitetit, dhe ky shërbim minimizon riskun për avari të ndryshme. Pjesa e oficinës është e veçuar si dhe e shtruar me nje siperfaqe betonit, e cila nuk lejon kontaktin direkt me sipërfaqen e tokës. Mbetjet urbane si: mbetje ushqimore, karton, letër, palastike etj, janë në një sasi fare të vogël dhe hidhen në kontenieret e Bashkisë.

3.2.3 Ndikimi në ajër

Pluhurat mund të shkaktohen gjatë shkarkimit të lëndës së parë (zhavor te dimensioneve të ndryshme, granil, rërë etj), si pasojë e faktorëve klimatike (era). Gjithashtu, makineritë e transportit, betonierja si dhe mjete të tjera të cilat do të levizin në vendin e punës do tëndikojnë në rritjen e gazeve në sipërfaqene objektit. Gjatë përzierjes së materialeve për përgatitjen e formulës së betonit do të sprucohet ujë me qëllim që minimizohet rritja e nivelit të pluhurave.

3.2.4 Ujëra të ndotura

Ujërat e ndotura që do të gjenerohen si pasojë e zhvillimit të aktivitetit të prodhimit të betonit do të vijnë nga dy burime: ujërat e ndotura urbane (ujërat e zeza), dhe ujërat që dalin nga

procesi teknologjik. Ujërat e zeza do të menaxhohen me gropë septike. Ndërsa ujërat që dalin si tepricë nga procesi I prodhimit të betonit, (pas kalimit në vaskat e dekantimit që kompania ka ndërtuar posacërisht për dekantimin) do të rifuten në proces ndërsa pjesa e tjetër. Këto ujëra kanë përbërje të imëta të materialeve si çimento, rërë,aditivë etj të cilat rrisin turbiditetin e ujit duke u tretur lehtësisht në të dhe si pasojë kërkon një kohë të gjatë për tu dekantuar. Këto ujëra nëse shkarkohen direkt në mjedise ujore pa u trajtuar më parë janë toksike për faunën ujore, duke qënë se përbërja e tyre është alkaline kanë një pH të lartë .

3.2.5 Zhurma dhe vibrime

Ky impakt do të vijë nga disa burime sikurse janë: makineritë e tranportit, betonieret, makineritë e vogla të terrenit, kompresori I ajrit, pompa e ujit etj. Procesi I impiantit të betonit shoqërohet me çlirim zhurme, por nuk vlerësohet të jetë në nivele të larta në zonë në të cilën operon. Në mënyrë që impakti të jetë sa më I vogël është e nevojshme që kompania të kryejë monitorim në laborator të akreditуar si dhe të respektojë normat e përcaktuara në udhëzimin Nr.8, datë 27.11.2007 "Per nivelet kufi të zhurmave". Shfaqja e fenomenit të vibrimeve mund të vijë gjatë lëvizjes së materialit në transaportier. Ky ndikim vlerësohet të jetë I papërfillshëm.

3.2.6 Gjenerimi I mbetjeve

Mbetjet urbane si letër, karton, plastikë , mbetje ushqimore janë në një sasi të papërfillshme, do të hidhen në kosha mbetjesh të cilat menaxhohen nga bashkia. Mbetjet qe do të dalin nga procesi I punës janë llumrat pas dekantimit të ujerave teknologjike (ujë I përzier me grimca rëre, cimento etj).

Duke qënë se brenda objektit do të kryhet dhe mirëmbajtja e makinerive, mund të krijohen dhe mbetje të tjera si bateri makinash, lecka të ndotura me hidrokarbure / vaj makinerish, goma etj. Transporti I këtyre mbetjeve duhet të kryhet vetëm nga kompani dhe makineri të licensuara me lejet përkatese si dhe të shoqërohet me dokumentin e transferimit të mbetjeve.

4 MASAT ZBUTËSE TË NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Masat zbutëse janë një grup masash të cilat meren në konsideratë paraprakisht në mënyrë që të minimizohen impaktet negative në mjedis dhe të lehtësojë fazën e rehabilitimit.

Masat zbutëse që duhet të ndërmerren gjatë aktivitetit :

Nga vlerësimet e kryera, shkarkimet e pritshme në mjedis janë të ulta dhe nuk përbëjnë problem serioz për mjedisin. Gjithsesi, duhet të tregohet kujdes në menaxhimin dhe mbajtjen nën kontroll të kushteve teknike për të minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

Masat që duhen konsideruar për të minimizuar ndikimin në mjedis janë:

• Duhet të tregohet kujdes në respektimin rigoroz të kushteve teknike në objekt për të reduktuar mundësitë e rënies se zjarrit në objekt dhe avaritë në sistem duke shmangur ndotjen në mjedis.

• Parandalimi i shkarkimeve të lëndës së parë në mjedis.

• Lidhur me mbetjet e grumbulluara të menaxhohen në bashkëpunim me subjekte të licensuara ose me subjektin e grumbullimit të mbetjeve urbane.

• Sasia depozituese të mos i kalojë volumet e parashikuara në mënyrë që situata të jetë e kontrollueshme dhe të mos dëmtoje peizazhin.

• Punonjësit të jenë të trajnuar paraprakisht dhe të jenë vazhdimisht në mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjatë proceseve të punës.

•Punimet e mirëmbajtjes të kryhen në përputhje me kushtet teknike të punës.

• Ndërtimi dhe mirëmbajtja e vaskës dekantuese të ujërave të përdorura.

• Monitorimi I vazhdueshëm mjedisor (ajër, zhurma, ujë) dhe raportimi periodik në organet kompetente.